

Njoftim i përqendrimit me të cilin Vienerberger AG nga Austria do të fitojë kontrollin e vetëm indirekt mbi Tereal Holding S.A.S. nga Franca

(lënda nr. 08-167 e vitit 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 29.12.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm indirekt nga Vienerberger AG, një shoqëri aksionare e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Austrisë, me seli në Vienerbergerplatz 1, 1100, Vjenë, Austria mbi Tereal Holding S. A.S., një shoqëri aksionare e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Francës, me seli të regjistruar në 13 Rue Pages, 92150 Suresnes, Francë, duke blerë të gjitha aksionet në Tereal Holding S.A.S. nëpërmjet një shoqëri të varur në pronësi të plotë të Vienerberger AG, Austri.

- **Vienerberger AG** është shoqëria mëmë e Grupit të Shoqërive Vienerberger, një furnizues ndërkombëtar i materialeve të ndërtimit dhe zgjidhjeve të infrastrukturës.

Grupi Vienerberger është aktiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë-Vienerberger SHPKNJP Vinicë, me aktivitet kryesor afarist - prodhimin e tullave, tjegullave dhe produkteve të argjilës së pjekur për ndërtim.

- **Ter-real Holding S.A.S.** është një prodhues i materialeve të ndërtimit, me vendndodhje në Francë. Shoqëria e synuar dhe shoqëritë e saj të varura që janë objekt i transaksionit të propozuar nuk kanë shoqëri të varura ose aktivitete në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

03.01. 2023

Shkup